



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



## E K S T R A K T

i procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Barazi Gjinore, mbajtur më 24.10.2022, duke filluar në orën 16:00.

Në mbledhje morën pjesë: anëtarët e komitetit: Violeta Salihu, Besart Krasniqi, Dhurata Jahaj -Retkoceri dhe Leonora Shabani – Bajraktari.

Mungoi: Gëzim Mehmeti.

Të pranishëm ishin edhe: Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale dhe Premtime Preniqi, kordinatore për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Violeta Salihu, kryesuese e komitetit dhe propozoi këtë

### REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Barazi Gjinore;
2. Organizimi i dy vizitave në QMF-të, e dy fshatrave me numër më të madh të banorëve;
3. Diskutim me drejtoren e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale për socializimin e viktimave të dhunës;
4. Diskutim për organizimin e një tryeze ku do të diskutohet lidhur me shkaqet dhe parandalimin e tyre kundër dhunës mbi baza gjinore;
5. Të ndryshme.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Barazi Gjinore

Kryesuesja konstatoi se njëzëri me 4 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Barazi Gjinore.

#### Pika e dytë

Organizimi i dy vizitave në QMF-të, e dy fshatrave me numër më të madh të banorëve

**Kryesuesja**, tha se ne si komitet e kemi menduar një vizitë në QMF në fshatin Bardhosh dhe në QMF në rrugën "Bajram Bahtiri", në Prishtinë, që për të qenë në dijeni se sa raste kanë kërkuar për me e bërë mamografinë, sa ka qenë numri i identifikuar dhe apo mos vërehet ndonjë rast i ri të sëmundjes së kancerit.

Lidhur me këtë po ashtu tha se për këtë vizitë do të e lajmërojmë edhe drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë. Këto vizita mundë t'i bëjmë po të njëjtën ditë dhe kemi menduar që t'i bëjmë të hënën më 31.10.2022.

#### **Pika e tretë**

#### **Diskutim me drejtoreshën e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale për socializimin e viktimave të dhunës**

**Adelina Sahiti**, drejtore tha se barazia gjinore është njëra prej çështjeve që duhemi me i dhënë prioritet, kur e dimë se kemi pasur raste të dhunës në familje dhe për këto raste ne kemi pasur një bashkëpunim të mirë me strehimoren.

Në ato strehimore gratë të cilat kanë përjetuar dhunë familjare mund të qëndrojnë maksimumi 6 muaj. Rastet e dhunës në familje janë shumë të shpeshta, dhe ne si drejtori fuqishëm mbështesim strehimoren. Në këtë objekte qëndrojnë gratë e keqtrajtuara pa pagesë dhe ata fëmijë të cilët i kanë me vete ne përkujdesemi me i dërgua në shkollë, në raste nevojë të mjeku etj.

Si drejtori, ne këtë strehimore e kemi përkrahur me mjete financiare pra e kemi vullnetin për t'i dalur në ndihmë kësaj kategorie që është shumë e ndjeshme. Jemi në hartim e sipër të një vendimi që do të subvenciononte këtë kategori të grave dhe konsideroi se ky lloj subvencionimi është një hap shumë i rëndësishëm që e bëjmë rreth socializimit të viktimave të dhunës.

**Kryesuesja**, kërkoi të dijë se ky lloj subvencionimi sa do të zgjatë.

**Adelina Sahiti**, drejtore tha se sa për fillim kemi menduar që subvencionimi të jetë një (1) vit.

**Kryesuesja**, po ashtu tha se komisioni i cili do të merret me këtë çështje duhet të jetë në nivelin e duhur për punën që e bënë e që mekanizmi i monitorimit të jetë shumë i përgjegjshëm.

Po ashtu gjatë këtij viti të qëndrimit në strehimore, do të ishte mirë që gratë të përcjellin ndonjë konkurs.

Po me këtë çështje jemi duke diskutuar edhe me OSBE-në, e që kemi idenë për një tryezë pune ku do të mblidhen të gjithë akterët që janë relevant, si Prokuroria, Policia, gjykatat për të diskutuar se çka mund të bëjmë më tutje kështu që me një koordinim të tillë do të jetë shumë më lehtë në zgjidhjen e këtyre problemeve.

**Leonora Shabani- Bajraktari**, tha se kemi shumë organizata që ofrojnë kushte sidomos për nënat vetushqyese, si ato organizata për ëmbëlsira, për rrobaqepësi dhe ato janë falas për nënat vetushqyese, andaj dhe ne duhet t'i shfrytëzojmë këta mekanizma.

Po ashtu do të ishte shumë e rëndësishme që më shumë të merremi me fëmijët me nevoja të veçanta, që ajo nënë e cila ka një (1) fëmijë me nevoja të veçanta të paguhet sikur t'i ketë dy (2) fëmijë, kështu që kjo të veçohet ndaj fëmijëve të tjerë.

## **Pika e katërt**

### **Diskutim për organizimin e një tryeze ku do të diskutohet lidhur me shkaqet dhe parandalimin e tyre kundër dhunës mbi baza gjinore**

**Kryesuesja**, tha se këtë tryezë të cilën do ta organizojmë do të bashkëpunojmë edhe me Premtimen, koordinatoren për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, e cila mendohet të jetë më 25.11. 2022.

**Adelina Sahiti**, drejtore tha se edhe ne do të jemi pjesëmarrëse në këtë tryezë, ku do të diskutohet për dhunën në familje.

**Kryesuesja**, ishte e mendimit që lidhur me këtë çështje edhe grupi i grave asamblistë me e bërë një seancë të jashtëzakonshme ku kryesisht do të diskutohej për dhunën në familje.

Lidhur me këtë ne do ta bëjmë një aktivitet në shesh me mesazh të viktimave, ku do të pasqyrohen përmes panove dhe qytetarët do të kenë rast me i lexuar ato mesazhe.

**Premtime Preniqi**, paraqiti në mënyrë grafike një lloj të formatit me mesazh të shkruar se si do dukej një pano, me mesazhe të viktimave të dhunës në familje.

**Kryesuesja**, tha se do ta përkrahim këtë ide të propozuar nga znj. Preniqi, ku do të shkruhen ato lloje të mesazheve, të përfshihen disa ide dhe të shkruhen në këtë pano. Për këtë aktivitet do të takohemi me OSBE-në, që të na përkrahë financiarisht.

Kjo pano do të jetë e vendosur në shesh prej 25 nëntor deri më 10 dhjetor 2022.

*Mbledhja përfundoi në orën 17:00.*

**Procesmbajtësi**  
**Zijadin Gashi**

**Kryesuesja e komitetit**  
**Violeta Salihu**



**Faqe3nga3**